



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/04
Datë: 07.06.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë


1. Shfuqizohet pika 6.1, 6.2, 6.3 dhe pika 6.4 e Vendimit të Qeverisë Nr.02/38 të datës 31 maj 2020 me të cilin është përcaktuar që:
 - 1.1. Të gjithë personat që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës dhe posedojnë rezultatin negativ për testin Covid-19 RT PCR (jo më i vjetër se 4 ditë) nuk i nënshtrohen procedurave të vet-izolimit;
 - 1.2. Ata që nuk kanë testin sipas pikës 6.1. detyrohen të vetë-izolohen për 7 ditë;
 - 1.3. Qytetarët që manifestojnë shenja klinike udhëzohen nga profesionistët shëndetësorë në pikat kufitare;
 - 1.4. Deri me datën 20 qershor do të bëhet rivlerësim i situatës epidemiologjike dhe me këtë do reflektohen masa të reja lidhur me pikat kufitare dhe hyrjen e qytetarëve në Republikën e Kosovës.
2. Pika 6. e Vendimit të Qeverisë Nr.02/38 të datës 31 maj 2020 me të cilin është përcaktuar që "Të gjithë personat që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, obligohen t'i nënshtrohen kontrolleve të ekipeve mjekësore të QKMF-ve (Qendrave kryesore të mjekësisë familjare) në pikat kufitare dhe t'i zbatojnë masat mbrojtëse kundër COVID19" mbetet e njëjtë.
3. Deri më 12 qershor 2020, Ministria e Shëndetësisë miraton "Manualin për Mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19" ku specifikohen të gjitha detajet për mënyrën e organizimit të punës në të gjitha bizneset private, ndërmarrjet publike, në institucionet publike dhe çdo veprimtari tjetër.
4. Autorizohet Ministria e Shëndetësisë që në pajtim me Ligjin të nisë procedurat e rekrutimit të dyqind specialistëve shëndetësorë që do të mbikëqyrin zbatimin e Manualit nga pika 3. e këtij vendimi.
5. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet situatë e qëndrueshme me rritje të lehtë të rasteve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë